

6 janar 2026,
Prishtinë

Bazuar në Rregulloren për Punën e Komisionit të Ankesave dhe të Arbitrazhit të Federatës së Basketbollit (FBK) të datës 31.01.2025, dhe Rregullores për Regjistrim dhe Kalim (RRRK) të datës 20.08.2025, si dhe sipas Ankesës së KB Golden Eagle Ylli të datës 06.01.2026, Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit i FBK-së ("KAA"), me datë 06.01.2026 merr këtë:

V E N D I M

- I. Shpallet e PRANUESHME Ankesa e KB Golden Eagle Ylli e datës 06.01.2026;
- II. APROVOHET Ankesa e KB Golden Eagle Ylli e datës 06.01.2026 si e BAZUAR;
- III. ANULOHET Vendimi Nr. 19/2025-26 i Komisionit të Garave i datës 06.01.2026;
- IV. OBLIGOHET FBK që të regjistrojë lojtarin Scott Bamforth si lojtar i KB Golden Eagle Ylli.

A R S Y E T I M

Më datë 06.01.2026, Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit i FBK-së ("KAA"), përmes postës elektronike, nga Sekretarja e FBK, ka pranuar Ankesën e KB Golden Eagle Ylli të datës 06.01.2026 (tash e tutje "Ankesa"), e cila ka të bëjë me Vendimin me nr. 19/2025-26 të Komisionit të Garave të datës 06.01.2026, (tash e tutje "Vendimi"), lidhur me refuzimin e regjistrimit të lojtarit Scott Bamforth si lojtar i lirë jashtë afatit për KB Golden Eagle Ylli.

Në këtë kuadër, KAA ka mbajtur takim lidhur me çështjen në fjalë, më 06.01.2026, dhe ka shqyrtuar Ankesën e KB Golden Eagle Ylli, si dhe provat e tjera që janë pjesë e dosjes së lëndës dhe të ofruara nga sekretaria. Njëheri, KAA ka shqyrtuar edhe praktikën e rasteve të tjera se si kërkesat e ngjashme janë trajtuar nga organet e FBK, përkatësisht Komisionin e Garave, lidhur me regjistrimin e tyre jashtë afatit si lojtarë të lirë.

Sipas kuptimit të KAA, KB Golden Eagle Ylli sfidon Vendimin e KG të identifikuar më sipër duke pretenduar ndër të tjera se kontrata e lojtarit Scott Bamforth ka skaduar, se aktualisht ky lojtar nuk ka kontratë në fuqi me ndonjë klub tjetër, se KB Golden Eagle Ylli është trajtuar në mënyrë të pabarabartë, dhe se Vendimi i Komisionit të Garave ka qenë i pabazuar në ndonjë dispozitë juridike

dhe ka qenë i vonuar. Rrjedhimisht, kërkon ndër të tjera nga KAA që të aprovojë ankesën, të anulojë Vendimin e KG, dhe të regjistrojë lojtarin Scott Bamforth si lojtar të KB Golden Eagle Ylli, si lojtar i lirë jashtë afatit.

KAA vëren nga provat në shkresat e lëndës, dhe është e pakontestueshme, se KB Golden Eagle Ylli ka dorëzuar brenda afatit ankesën e tyre ndaj Vendimit të Komisionit të Garave, dhe rrjedhimisht, konsiderohet si ankesë e pranueshme sepse janë përmbushur të gjitha kushtet, përfshirë edhe pagesën e taksës për ankesë.

KAA gjatë trajtimit të lëndës ka shqyrtuar të gjitha dokumentet përkatëse dhe provat në dispozicion, bazën ligjore dhe nënligjore, dhe rregullativën e brendshme të FBK-së, si dhe praktikën e rasteve të tjera se si kërkesat e ngjashme janë trajtuar nga organet e FBK, përkatësisht Komisionin e Garave, lidhur me regjistrimin e tyre jashtë afatit si lojtarë të lirë, dhe ka konstatuar si në dispozitiv, për arsyet në vijim.

KAA potencon se dispozita përkatëse që trajton këtë rast është Neni 13.6 i RRRK i cili thotë:

6. Lojtari i lirë (free agent) i cili nuk ka kontratë aktive/valide me asnjë klub basketbolli në momentin e përfundimit të afatit kalimtar, mund të regjistrohet jashtë afatit kalimtar vetëm në rastet e mëposhtme:

- 6.1. Dëmtimi i një lojtari të ekipit aktual që pritët të zgjasë për një periudhë më të gjatë se dy muaj;
- 6.2. Largimi ose pezullimi i një lojtari të ekipit për një periudhë më të gjatë se dy muaj për arsye disiplinore ose personale;
- 6.3. Situata të tjera të jashtëzakonshme të cilat pengojnë ekipin nga pjesëmarrja konkurruese e rregullt, të aprovuara paraprakisht nga Komisioni i Garave.
- 6.4. Përrjashtimisht, sipas vlerësimit të Komisionit të Garave, do konsiderohet lejimi i regjistrimit të lojtarit të lirë jashtë afatit kalimtar nëse kjo është në interes të basketbollit kosovar / përfaqësimit kombëtar.

Në rastin konkret, është e qartë nga dosja e lëndës se lojtari Scott Bamforth nuk ka kontratë aktive/valide me asnjë klub basketbolli tjetër. KAA vlerëson se kontrata që lojtari në fjalë ka pasur me ekipin meksikan ka skaduar, dhe si e tillë, nuk është më në fuqi—kjo vërtetohet edhe nga

dokumenti “Letter of Clearance” i datës 29.12.2025. Prandaj, konsiderohet se ky lojtar nuk ka kontratë aktive/valide me ndonjë klub tjetër.

Duke vlerësuar kushtet e tjera që duhet shqyrtuar për të lejuar një lojtar të lirë që t'i bashkohet një ekipi jashtë afatit, ato nga 1 deri 4 në Nenin 13.6 të RRRK, KAA vlerëson se nuk ka prova se pikat 1 deri 3 përmbushen. Mirëpo, KAA konstaton se pika 4 nga Neni 13.6 i RRRK është e aplikueshme në këtë rast, pasi që “kjo është në interes të basketbollit kosovar / përfaqësimit kombëtar”.

Prezenca e një lojtari të kualitetit të lartë si Scott Bamforth në ligën e Kosovës detyrimisht që ka ndikim pozitiv në nivelin e basketbollit kosovar, jo vetëm brenda Kosovës por edhe në pjesëmarrje të klubeve të Kosovës në gara ndërkombëtare. Poashtu, edhe më e rëndësishme, ky lojtar ka shtetësinë e Republikës së Kosovës, dhe si kosovar, ka përfaqësuar shtetin ashtu si në vijim:

Scott Bamforth ka luajtur 7 ndeshje me Përfaqësuesen e Kosovës, me ç'rast është ndër lojtarët e natyralizuar me më së shumti paraqitje për Kosovën.

- 2023 - FIBA EuroBasket 2025 Pre-Qualifiers (1 ndeshje);
- 2019 - FIBA EuroBasket 2021 Pre-Qualifiers (1 ndeshje);
- 2019 - FIBA Basketball World Cup 2019 European Qualifiers (2 ndeshje);
- 2017 - FIBA Basketball World Cup 2019 European Pre-Qualifiers (2 ndeshje);
- 2016 - FIBA EuroBasket - Qualifiers (1 ndeshje).

Në fakt, sipas informatave që ka KAA në dispozicion, lojtari Scott Bamforth nuk ka refuzuar asnjëherë ftesën për paraqitje me Përfaqësuesen e Kosovës. KAA gjithashtu vlerëson se aktivizimi i tij në Superligën e Kosovës hap sërish mundësinë që ky lojtar të ftohet sërish nga Përfaqësuesja e Kosovës në ndeshjet e radhës, që do ishte një ndihmë e madhe dhe në interes të veçantë të përfaqësimit ndërkombëtar të Kosovës.


Në fakt, KAA poashtu e ka parasysh se ky Vendim i KAA-së është në linjën e njëjtë edhe me praktikën e krijuar edhe nga vet Komisioni i Garave—ku është lejuar regjistrimi i lojtarëve të lirë jashtë afatit—ku vlen të përmenden disa nga këto raste të aprovuara nga Komisioni i Garave:

- Vendimi Nr. 11 2025-26 - miratohet kërkesa e KB Bashkimi për lejimin e regjistrimit të lojtarit të lirë Muhamedali Janjeva;
- Vendimi Nr. 12 2025-26 - miratohet kërkesa e KB Istogu për lejimin e regjistrimit të lojtarit të lirë Nderim Januzaj;

- Vendimi Nr. 13 2025-26 - miratohet kërkesa e KB New Basket për lejimin e regjistrimit të lojtarit Ujkan Karanezi;
- Vendimi Nr. 18 2025-26 - miratohet kërkesa e KB Sigal Prishtina për lejimin e regjistrimit të lojtarit Altin Morina.

Në këtë aspekt, është evidente për KAA se lojtari Scott Bamforth është dashur të regjistrohet nga KG si lojtar i KB Golden Eagle Ylli, bazuar në Nenin 13.6.4 të RRRK. Andaj, edhe KAA, duke u mbështetur në atë që u tha më lartë, ka vendosur si në dispozitiv, që të obligohet FBK që të regjistrojë lojtarin Scott Bamforth si lojtar të KB Golden Eagle Ylli.


Komisioni i Arbitrazhit:



Partin Pruthi
Anëtar



Korab R. Sejdiu
Kryetar



Lulzim Fushtica
Anëtar

Prishtinë, 6 janar 2026

Vendimi i dërgohet:

- KB Golden Eagle Ylli
- Komisionit të Garave të FBK-së
- Anëtarëve të Komisionit të Arbitrazhit
- Arkivit të FBK-së



Këshilla Juridike:

Vendimet e Arbitrazhit janë definitive, dhe kundër tyre nuk është e lejuar ankesa brenda FBK-së. Palët e pakënaqura me vendimin e KAA kanë të drejtë të ankesës tek Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS) dhe në Gjykatën kompetente përkatëse.